REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 892/20
Datë/Datum. 05.11.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: ***Kuvendin Komunal Pejë***

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: 635-20-4235-5-2-1

Sa i përket tenderit për Ndërtimi i katër urave mbi shtratin e lumit " Lumbardh në Peje "

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

"VELLEZRIT HOTI" SH.P.K. & "MIRUSHA COMPANY"SHPK *(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)*

Dollc- Klinë pa nr-Abedin Rexha *(Adresa)*

Klinë *(Kodi postar)* **32000** *(Vendi)*

044-128-771 *(Numri Telefonit)* _____ *(Numri i Faks-it)*

Faik Hoti;Fidan Selimi
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)
vellezrithoti75@gmail.com
(Adresa elektronike)

SH.P.K VELLEZRIT HOTI 810136540 DOLLC-KLINË

05.11.2020
(Data e parashtrimit të ankesës) _____ *(Nënshkrimi dhe vula)*

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

_____

(Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____

(Adresa elektronike)

_____ _____

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

B05 Njoftim per Kontrat: 06.08.2020 ne web faqen E-prokurimit.
Afati për dorëzimin e ofertave/kërkesës për pjesëmarrje :26.08.2020 ,ora 14:00 ne web faqen e-prokurimit.

PROCESI I HAPJES.PDF:26.08.2020 ne web faqen E-prokurimit.

NJOFTIM MBI VENDIMIN E AK.pdf:02.09.2020,ne web faqen e-prokurimit-Dokumentet e pranuara.

VENDIM MBI PEZULLIMIN E AKTIVITETIT TË PROKURIMIT.pdf:08.09.2020, ora 15:00,ne web faqen e-prokurimit.

NJOFTIM MBI VENDIMIN E AK RI VLERSIM.pdf:23.10.2020, ora 13:42ne web faqen e-prokurimit.

VENDIM MBI PEZULLIMIN E AKTIVITETIT TË PROKURIMIT RIVLERSIM.pdf:23.10.2020, ora 14:14 ne web faqen e-prokurimit.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒ ***Jo*** ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ **Jo** ☐

Kemi bërë Kërkesë për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues me datën 07.09.2020 dhe kemi pranuar Vendimin mbi Refuzimin e Kërkesës për rishqyrtim me datën 08.09.2020.
Arsyet tona të paraqitura në Kërkesë për rishqyrtim lidhur me shkeljet e dispozitave ligjore të Ligjit te Prokurimit nuk janë marrë për bazë dhe janë refuzuar nga Autoriteti Kontraktues, por kjo nuk qëndron .
Kemi bërë Kërkesë për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues për heren e dytë pas vendimit te OSHP-së të dates :16.10.2020, pasi OSHP-ja e ka kthyer ne rivlerism lënden AK-së e ka shpallë po te njejtin dhe ne kemi bërë Kërkesë për rishqyrtim me datën 27.10.2020 dhe kemi pranuar Vendimin mbi Refuzimin e Kërkesës për rishqyrtim për heren e dytë me datën 28.10.2020.
Arsyet tona të paraqitura në Kërkesë për rishqyrtim për heren e dytë janë sepse nuk e ka rrespektu vendimin e panelit shqyrtues lidhur me shkeljet e dispozitave ligjore të Ligjit te Prokurimit nuk janë marrë për bazë dhe janë refuzuar nga Autoriteti Kontraktues,

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

1.Neni 7 LPP- së
2.Neni 59- LPP-së
3.Neni 60- LPP-së
4.Neni 64- LPP-së
5.Neni 69- LPP-së
6.Neni 72- LPP-së
7.Neni 108/A- LPP-së

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Te nderuar pasi kemi pranua letrën standarde për tenderues te pasukseshem e kemi pranuar permes platfomes elektronike , me pas kemi kerkuar qasje ne dokumentacion , pas qasjes kemi vërejtur numer të madhe te shkeljeve qe ka bere Autoriteti Kontraktues ne momentin e shpalljes se Operatorit Ekonomike N.P.T. "BAKALLI METAL"

Pas rivlerësimit nga ana e AK-së kem vrejtur se nuk ka bërë rivlerësim te drejtë edhe pas kërkese se Panelit shqyrtues te nxjerru me vendim te dates:16.10.2020 sepse OE i propozuar per dhenje te kontrates nuk e ploteson kriteret siq janë: Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale:

Kërkesa 2

Menaxheri i projektit Inxhinieri i diplomuar i ndërtimtaris ose master drejtimi konstruktiv ,me provoj pune minimum 3 vjeqare.

Dëshmia 2

Për Menaxherin e projektit (inxhinieri) duhet te ket Diplomen-kopje , vendim për Projektmenagjer i vulosur dhe nenshkruar nga Kompania si dhe CV e nënshkruar nga vetë inxhinieri .

Kërkesa 3

Stafi i lartë profesional që do të kyqet në projekt minimum 2 inxhinerë

- **Një (1) inxhinjer i diplomuar i Gjeodezis (ose master)-,minimum 3 vite përvoj pune pas diplomimit.**
- **Një (1) inxhinjer i diplomuar i Elektros (ose master)-,minimum 3 vite përvoj pune pas diplomimit.**

Dëshmia 3

Për stafin professional (inxhinierët) duhet të ken Diplomat-kopje, kontrata apo parakontrata në emer të projektit dhe CV-ja e nënshkruar nga vet inxhinjerët.

Ne dosjen e ngarkuar nga OE i propozuar per kontrate shihet qartë se nuk e ka plotësuar kërkesen te menaxheri i projektit pasi kërkesa e FDT-së është **"Vendim për Projektmenagjer i vulosur dhe nenshkruar nga Kompania" .Këtë dokument nuk e ka paraqitur OE dhe prandaj nuk e plotëson kushtin e FDT-së.(Gjeni te bashkangjitur deshmin).**

Sa i përket kërkese 3 për - Një (1) inxhinjer i diplomuar i Gjeodezis (ose master)-,minimum 3 vite përvoj pune pas diplomimit. OE i propozuar për kontratë ka prezantuar Butrint Marmullakun i cili posedon titullin Bachelor i Gjeodezisë ,kuse kërkesa e FDT-së është) inxhinjer i diplomuar i Gjeodezis (ose master)-,minimum 3 vite përvoj pune pas diplomimit prandaj nuk e plotëson kushtin e FDT-së.(Gjeni te bashkangjitur deshmin).

Sa i përket kërkese 3 për- Një (1) inxhinjer i diplomuar i Elektros (ose master)-,minimum

3 vite përvoj pune pas diplomimit .OE i propozuar për kontratë ka prezantuar Hamit Krasniqi i cili posedon titullin Bachelor i Inxhinierise Elektrike ,kuse kërkesa e FDT-së është) inxhinjer i diplomuar i Elektros (ose master)-,minimum 3 vite përvoj pune pas diplomimit prandaj nuk e plotëson kushtin e FDT-së. .(Gjeni te bashkangjitur deshmin).

Autoritet kontraktues ka shpallu fitues nje Operator Ekonomike , i cili ne momentin e dorzimit te ofertes si dhe pas sqarimeve te kerkuar nuk e ka plotesuar Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale konkretisht Dëshmi qe ka përfunduar projekte të ngjajshme në tri vitet e fundit , Operatori ekonomikë ka prezentuar Aneksini duke i bashkangjitur kontrata dhe referenca me kompani private duke mos ja bashkangjitur edhe dëshmit fletapagesat nga banka apo dëshmi tjetër që ka arkëtuar mjete sipas Referncave të prezentuara , pas parashtrimi të Kerkese per Rishqyrtim Autoriteti Kontraktues i ka kerkuar Sqarime Operatorit Ekonomike te shpallur fitues , i njëjtin Opertaore Ekonomike ka ofruar deshmi qarkullim bankar , por që ka mosperputhje të medha ne mes së kontratave te lidhura dhe Pagesave të pranuar dhe nuk e mbulon kerkesen ne FDT :
Kontrata me kompanin Ventius Kosova LLC është lidhur me daten 16.03.2019 dhe ka perfunduar me daten 23.12.2019 në vlere financiare 65.000,00 euro , referencen e ka të leshuar me daten 23.12.2019 ne vleren 65.000,00 euro , kur analizojmë pasqyren bankare qe na ka ofruar Autoriteti Kontraktues del që NTP Bakalli Metal ka pranuar pagesa para dates së nënshkrimit të kontrates dhe ate nga data 17.07.2017 e deri me 06.12.2018 ka pranuar mjete ne vler finaciare 62.812.85 , ndersa ne emer te kontrates së prezentuar ka pranuar 11.146,00 euro , duke marr për bazë analizën e lartë cekur konsiderojme që kjo Referencë nuk e ka vleren siq shihet por duhet ti llogaritet vetem vlera nga data e leshmit të kontrates e deri ne daten e perfundimit që është vlera finaicare 11.146,00 euro nga që pagesat para dates së nënshkrimit të kontrtes nuk duhet ti pranohen , po ashtu ka transakcion bankare para dates së nënshkrimi të kontrtes ku shihet qe NPT Bakalli i ka transefuar mjete Ventius Kosova LLC dhe atë ne datat 06.12.2018 , 04.05.2018 , 27.04.2018 si dhe 13.12.2017 .
Kontraten e lidhur me Devolli Co me daten 23.06.2019 e perfunduar me 13.07.2020 ne vlere finaciare 185.000,00 euro dhe me refernce te leshuar me daten 13.07.2020 ne po atë vlere , Operatori Ekonomike nuk ka ofruar asnje deshmi bankare qe ka pranuar keto mjete , andaj konsiderojme që kjo Referncecë është e pa bazë dhe nuk ka bazë ligjore të pranohet .
Kontraten e lidhur me New Co Fabrika e Amortizatorve sh.p.k.të lidhur me daten 10.06.2019 dhe te perfunduar me daten 01.06.2020 ne vlere financiare 69.064,00 euro dhe me refernce te leshuar me daten 01.06.2020 ne po atë vlere, në bazë të 9/3 *qarkullimit bankare te ofruar nuk përputhet vlera finaciare e references nga që pagesen e parë e ka para datese së nënshkrimit të kontrates konkretisht me daten 17.08.2017 ne vleren finacare 13.477,60 euro si dhe dy pagesa i ka pas lëshimit të references me datat 26.06.2020 ne vleren finacare 2000.00 euro ,si dhe me daten 23.07.2020 ne vleren finacare 484.74 euro , andaj si reference duhet ti llogaritet vetem vlera finaciare 61.580.28 euro .*
Kontrata e lidhur me BK-Construction shpk në vlere finaciare 14.250,00 euro me daten 28.06.2019 e perfunduar me daten 12.09.2019 , me refernce te leshuar me daten 12.09.2019 ne po atë vlere , nuk ka ofruar asnje deshmi bankare qe ka pranuar keto mjete , andaj konsiderojme që kjo Referncecë është e pa bazë dhe nuk ka bazë ligjore të pranohet .
Kontrata e lidhur me Martius LLC ne vlere finaciare 63.711,00 euro me daten 05.08.2019 e perfunduar me daten 01.06.2020 dhe me refernce te leshuar me daten 01.06.2020 ne po atë vlere , ne deshmi e ofuara nuk përputhen me Refenecen e lëshuar , në bazë të qarkullimit ka dëshmi që ka pranuar mjete finaciare nga data 28.08.2019 e deri me daten 20.07.2020 ne vlere finaciare

47.500,00 euro dhe pas pranimi të reference ka pranuar edhe 3.000,00 euro , andaj kjo reference duhet ti llogaritet vetem vlera finaciare 47.500,00 euro dhe jo siq e ka ofruar Reference 63.711,00 euro .
Në bazë të Analizimit të Raportit Bankarë dhe Kontratave me Refernca te doruzar konstatojme qe Operatori Eknomike N.P.T. "BAKALLI METAL" ka ofruar dëshmi për përfundimi e punëve të ngjajshem gjatë tri viteve të fundit si vijon :
1. Kontraten me Ventius Kosoca LLC ka reference vleren fianciare 11.146,00 euro
2. Kontraten me Devolli Co nuk ka deshmi mbi qarkullimin bankare dhe referenca është e pa bazë
3. Kontraten me New Co Fabrika e Amortizatorve sh.p.k. ka reference vleren fianciare 61.580,00 euro
4. Kontraten me BK-Construction shpk nuk ka deshmi mbi qarkullimin bankare dhe referenca është e pa bazë
5. Kontraten me Martius LLC ka reference vleren fianciare 47.500,00 euro
Vlera e kontratave me refernca në tri vitet e fundit
120.226,00 euro
Andaj , konstatojme qe Operatorit Ekonomike i shpallur fitues N.P.T. "BAKALLI METAL" është i papergjegjshem , nga që nuk ka permbushur kriterin siq kerkohet ne FDT
Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka perfunduar me sukses kontratat për projekte të ngjajeshme (punë me konstrukcione metalike,) në vler prej 200.000.00 Euro në 3 (tri) vitet e fundit, duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për Kontrat.
dhe automatikisht duhet të shpallet i pa pergjegjëm dhe të eliminohet.

Andaj ju si AK-se nuk e keni respektu nenin 59 të LPP-së ,sepse na keni eleminuar neve si GOE edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FDT-së dhe te njoftimit për kontratë,ndërsa e kemi plotësuar edhe kriterin kryesore për dhenie të kontratës,e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ultë sipas nenit 60 paragrafit 1.1 i LPP-së.

Ju si AK-së në këtë vlerësim dhe vendim na keni diskriminuar neve si GOE në kundërshtim me nenin 7-të LLP-së dhe njëkohësisht e keni favorizuar OE të rekomanduar për kontratë,ndërsa në paragrafin 1 të nenit 7 të LPP-së parashihet qartë "Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo -diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente".

Duke i treguar argumentet e cekura me lartë kërkojm të anulohet vendimi për dhënjë për OE,dhe të na shpallni ne si GOE fitues të përgjegjshem me çmimë më të ultë.

Në fund kërkojmë nga OSHP-ja ,që të nxjerr:

VENDIM
Aprovohet ankesa e GOE "VELLEZRIT HOTI" SH.P.K. & "MIRUSHA COMPANY"SHPK e bazuar.
Anulohet njoftimi për dhënie të kontratës i AK-së.
Te nxjerret vendimi nga OSHP-ja ku ne të shpallemi fitues si GOE i përgjegjesh me çmim më të ultë.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Janë bërë dëme materiale ne vlere monetare mbi 10.000,00 euro dhe jomateriale për parapërgatitjen,përgatitjen dhe udhëheqjen e procesit për dorëzimin e ofertës (Shpenzime te letrës,stafit që kanë përgatitur ofertën,shpenzimet e sigurimit te tenderit, shpenzime te shërbimeve si noterizimet etj,shpenzimet e transportit si dhe dëmi moral lidhur me transparencën dhe jodiskriminimin).

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*